



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE LAJME

qershor 2018
BEQ-numër 35/2018



KONKLuzionet PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË TË MIRATUARA NË KËSHILLIN E BASHKIMIT EVROPIAN



Këshilli për Punë të Përgjithshme të BE-së në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018 në Bruksel, e përshëndet faktin se kriza e thellë politike në vend është tejkaluar, ndër tjerash edhe zbatimin e vazhdueshëm të Marrëveshjes së Przhinos dhe progresin në reformat prioritare urgjente. Këshilli përkujtoi se rëndësia për vendosjen e mëtejshme të përgjegjësisë juridike nga përgjimet e vitit 2015, ndërsa me këtë edhe mangësitë e lidhura në drejtim të mbikëqyrjes, si dhe se duhet të përcaktojnë përgjegjësi për sulmin në Parlament më 27 prill 2017. Këshilli e inkurajoi zbatimin e mëtutjeshëm të strategjisë për reforma në jurisprudencë, për përpjekjet plotësuese për realizimin e rekomandimeve të tjera dhe për realizimin e rezultateve plotësuese konkrete.

Këshilli dha mbështetje të gjitha palët të mbajnë dialog konstruktiv dhe të vazhdojnë të thellojnë momentin reformues aktual në veçanti në reformat kryesore të sundimit të të drejtës, luftën kundër korrupsionit dhe krimin e organizuar, reforma në gjyqësor, luftë kundër radikalizmit dhe terrorizmit si dhe reforma në shërbimet e zbulimit.

Duke e pasur parasysh progresin, në veçanti zbatimin e Marrëveshjes së Përzhinos, prioritetet reformuese urgjente dhe momenti pozitiv nga marrëveshja me Greqinë për çështjen e emrit, Këshilli u pajtua të japë përgjigje pozitive për progresin të cilin e realizoi Republika e Maqedonisë si dhe për përcaktimin e udhëzimeve të cilat duhet t'i ndjekë për realizimin e negociatave aderuese në qershor 2019. Në pajtim me këtë, Këshilli theksoi nevojën e pa prolongueshme Republika e Maqedonisë të vazhdojë të realizojë progres konkret në prioritetet reformuese urgjente dhe të arrijë rezultate të dukshme në luftën kundër korrupsionit si dhe mbajtjen dhe përforcimin e nivelit të momentit reformues. Për këtë qëllim, Këshilli i bëri thirrje Komisionit Evropian në mënyrë të zgjuar të ndjekë përpjekjet e vendit dhe zbatimin e reformave dhe të vlerësojë progresin e realizuar në raportin vjetor të Komisionit.

Këshilli i BE-së përkujtoi se vendimi për hapjen e negociatave aderuese me Republikën e Maqedonisë do të jetë lëndë e përfundimit të procedurave parlamentare nacionale dhe miratim nga Këshilli i Evropës dhe se së shpejti pas atij vijon konferenca e parë ndër qeveritare deri në fund të 2019, në varësi të progresit të realizuar. Këshilli theksoi se në vlerësimin e

progresit të realizuar duhet të përfshihen rezultate të mëtejshme të dukshme dhe të qëndrueshme me fokus të veçantë në:

- reforma në jurisprudencë dhe hetime proaktive, akuza dhe vendime gjyqësore të plotfuqishme në rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar, përfshirë edhe ato të nivelit të lartë,
- reforma në shërbimet e zbulimit dhe të sigurisë
- reforma në administratën publike.

Këshilli e mori parasysh qëllimin e Komisionit të fillojë me punën e nevojshme përgatitore.

Në mënyrë plotësuese në takimin më 29 qershor në Bruksel, Këshilli i Evropës fuqishëm e përshëndeti dhe e mbështeti marrëveshjen e arritur ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Greqisë për çështjen e emrit. Me atë dhe me marrëveshjen për miqësi dhe raporte të mira fqinjësore dhe bashkëpunim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bullgarisë, jepet shembull i fuqishëm për të tjerët në rajon t'i përforcojnë raportet e mira fqinjësore. Këshilli i Evropës i konfirmoi konkluzat për zgjerimin dhe procesin e stabilizim dhe asociimit, të cilat paraprakisht i miratoi Këshilli i BE-së më 26 korrik.

Përmbajtja e lajmeve:

Konkluzionet për RM-në të miratuara në Këshillin e BE-Parlamentit Evropian	1
Në fokusin e Aktivitetit të Kuvendit në lidhje me çështje Evropiane	2-3
Aleanca klimaterike ndërmjet biznes komunitetit dhe shoqërisë civile	4-5
Ditët evropiane të Studim për subvencionimin e karburanteve të fosileve	6
Agjenda digjitale për	7
Programi investues për mbështetjen e vendeve të punës, rritjen e investimeve në Evropë	8
Prodhim i zvogëluar i cigareve në Bashkimin Evropian	9
BE kalendar / korrik	10
	11

NË FOKUS TË PARLAMENTIT EVROPIAN

Seancë plenare 11-14 qershor 2018



Në seancën plenare eurodeputetët e miratuan marrëveshjen e arritur ndërmjet negociuesve të Këshillit dhe Parlamentit më nëntor 2017 me qëllim të sigurohen nivel i përbashkët i sigurisë dhe t'u ofrohet operatorëve dhe prodhuesve parashikueshmëri për zhvillim të prodhimeve dhe shërbimeve. Për momentin shumica e mjeteve fluturuese pa pilot u nënshtrohen rregullave të ndryshme nacionale, që mund ta pengojë zhvillimin e tregut. Sipas rregullave të reja, mjetet fluturuese pa pilot duhet të jenë të dizajnuara pa rreziqe për njerëzit. Në bazë të rrezikut në lidhje me p.sh. peshën e mjetit fluturues pa pilot do të nevojiten funksione shtesë, si ulje të automatizuar në rast se operatori e humb lidhjen me mjetin fluturues pa pilot apo sistemin për shmangien e ndeshjeve.

Komisioni Evropian duhet të zhvillojë rregulla më të detajuara për fluturim me mjet fluturues pa pilot dhe cilat operacione të mjeteve fluturuese pa pilot do të duhet të jenë të certifikuar në bazë të rrezikut që mund të shfaqin. Rregullat do të përcaktojnë cilëve operatorë u nevojitet trajnim shtesë, regjistrim dhe karakteristika plotësuese të sigurisë për lloj të caktuar të mjeteve fluturuese pa pilot. Për momentin, mjetet fluturuese pa pilot më të vogla se 150 kilogram janë nën kompetencat e autoriteteve nacionale dhe për atë arsye prodhuesit dhe operatorët u nënshtrohen kërkesave të ndryshme për dizajn dhe siguri. Rregullat e reja duhet të miratohen nga ana e ministrave të BE-së.

Kryeministri i Holandës, Mark Rute, debatoi për ardhmërinë e Evropës me eurodeputetët dhe zëvendësin e parë të kryetarit të Komisionit Evropian Frans Timmermans. "Debati për ardhmërinë e BE-së duhet të jetë për çështjen ku BE-ja mund të shtojë vlerë. Besoj se ardhmëria e Evropës në esencë duhet të angazhohet për premtimin e parë për Evropën. Premtime të vendeve-anëtare sovraane se punojnë bashkë, t'i ndihmojnë njëra tjetrës për të arritur prosperitet më të madh, siguri dhe stabilitet", theksoi kryeministri i Holandës.

Krahas zvogëlimit të numrit të vendeve të deputetëve në Parlamentin Evropian prej 751 në 705 përfaqësues, rishpërndarja e propozuar

e vendeve, që u miratua unanimisht gjithashtu, do të lë 46 prej 73 vendeve të lira nga shkëputja e Britanisë së Madhe, në rezervë. Pjesë e vendeve apo të gjitha 46 vendet mund të shpërndahen për vendet e reja që anëtarësohen në BE ose do të mbesin të zbrazëta. 27 vendet tjera do të jenë sërish të shpërndara për 14 vendet-anëtare të BE-së të cilat nuk kanë dallim shumë më të vogël të përfaqësimit. Propozim-vendimi i Këshillit Evropian është miratuar me 566 vota "pro", 94 "kundër" dhe 31 vota "të përmbytur". Për vendimin e propozuar për përbërjen e re të Parlamentit Evropian do të nevojitet leje formale edhe nga liderët në BE samitin në Bruksel me 28 dhe 29 qershor. Vendimi do të hyn në fuqi me ditën e publikimit në Gazetën zyrtare të BE-së.

Sipas nenit членот 14 (2) të Marrëveshjes për Bashkimin Evropian, numri i anëtarëve të Parlamentit Evropian nuk mund të jetë më shumë se 750, përfshirë kryetarin. Përfaqësimi duhet të jetë "me proporcionalitet depresiv", me limit minimal prej gjashtë anëtarëve për çdo vend-anëtar, asnjë vendi-anëtar nuk mund t'u ndahen më shumë se 96 vende. Kjo donë të thotë se shpërndarja e vendeve në Parlamentin Evropian duhet t'i pasqyrojë lëvizjet demografike në vendet e BE-së.

<http://www.europarl.europa.eu>

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN

Sesion i planifikuar 11-14 qershor 2018

Eurodeputetët dhanë pëlqimin për propozimin e Komisionit për sigurimin edhe të një pakoje të ndihmës makro-financiar (MFA) në Kiev, që paraqet një resurs të jashtëzakonshëm urgjent për vendet nga fqinjësia e BE-së.

Eurodeputetët, prapë se prapë insistuan që Parlamenti, Këshilli dhe Komisioni Evropian të japin deklaratë të përbashkët për kushtet politike të cilat Ukraina duhet t'i plotësojë, për shkak brengosjes rreth tempos së reformave dhe luftës kundër korrupsionit në vend.

Ndihma makro-ekonomike e BE-së është instrument i jashtëzakonshëm urgjent për ballafaqim me vështirësi financiare në vendet e fqinjësisë së BE-së. Nga fillimi i krizës në vitin 2014 në Ukrainë, ky ishte programi i tillë i katërt, krahas llojeve të tjera financiare të BE-së në vend. Deri tani janë harxhuar gjithsej 2,8 miliardë euro, por kësti plotësues prej 600 milionë euro u anulua në janar 2018 për shkak të mospërfitimit të Ukrainës që të ndërmerr masat me të cilat është e kushtëzuar kredia.

Parlamenti Evropian miratoi Rezolutë për mbrojtje kibernetike, me 476 vota, 151 kundër dhe 36 të përmbajtur. Në rezolutë është shënuar se Rusia, Kina, Koreja e Veriut si dhe aktorë të tjerë jo shtetëror, kanë kryer sulme me qëllime kriminele mbi infrastrukturën kritike në BE, të azhurnuara në spiunazh kibernetike dhe mbikëqyrje masive të qytetarëve të BE-së, udhëheqjen e fushatës për dezinformim etj. Në debat eurodeputetët theksuan se strategjitë e fragmentuara mbrojtëse e kanë Evropën të ndjeshme në sulmet kibernetike. Eurodeputetët i bënë thirrje vendeve anëtare të BE-së që ta rrisin aftësinë e forcave të tyre të armatosura, që të punojnë së bashku dhe ta përforcojnë bashkëpunimin kibernetikë në nivel të BE-së, me NATO-n dhe partnerët tjerë. Kjo domethënë se do të ketë më shumë ushtrime të përbashkëta kibernetike, trajnime dhe shkëmbim të oficerëve për regrutim nga ekspertiza e kibernetikës, si

dhe përmirësim të ekspertizës për mbrojtje kibernetike të misioneve dhe operacioneve të BE-së.

Në rezolutën e veçantë për marrëdhëniet BE-NATO, e miratuar me 411 vota, 182 kundër dhe 57 të përmbajtur, eurodeputetët theksuan se asnjë organizatë nuk ka plotësisht kapacitet që të ballafaqohet me sfidat e sigurisë, të cilat janë më pak konvencionale dhe hibride.

Eurodeputetët, do të debatojnë më të gjerë dhe do të votojnë për propozimet për ndryshimin e rregullave të punëtorëve në sektorët për transport rrugor, për përmirësimin e kushteve për pushim dhe përmirësim të zbatimit për zbatimin e praktikave ilegale, në sesionin plenar që duhet të mbahet në korrik të këtij viti. Të tre propozimet për publikimin e vozitësve, periudhat për pushim të vozitësve dhe qasje në operatorin e transportit rrugor dhe tregun e komunikacionit rrugor për ballafaqim me praktikën ilegale, siç është përdorimi i kompanive me kuti postare, janë pjesë e paketës për mobilitet të ngritur nga Komisioni në maj 2017.



<http://www.europarl.europa.eu>

AKTIVITETET E KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE



www.sobranie.mk

Nga 27 deri më 29 qershor në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë u mbajt Seminari i 98-të ROS-ROT me temë „Integrimi euroatlantik i Ballkanit Perëndimor: përforsimi i projektit paqësor evropian“.

Fjalime përshëndetëse patën Ilija Dimovski, shef i Delegacionit të Kuvendit në AP-në e NATO-s, Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, kryetari i AP-së së NATO-s, Paolo Ali, ambasadorja zvicerane në Republikën e Maqedonisë, Sibil Suter Tejada, si dhe kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Zoran Zaev. Fjalim kryesor pati Xhejms Perdju, ish deputeti special amerikan i Ballkanit dhe zëvendësndihmës i sekretarit të përgjithshëm të NATO-s për operacione.

Seminari i 98-të ROS-ROT u mbajt në 3 sesione të përkushtuara në: “Përforsimin e sundimit të së drejtës, reformën në administratë dhe jurisprudencë, luftën kundër korrupsionit”; “Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe stabiliteti i Ballkanit Perëndimor: masat për ndërtimin e besimit reciprok” dhe “Kriza e emigrantëve dhe ruta ballkanike”

Në organizim të RAKVIAK - Qendrës për Siguri dhe Bashkëpunim, Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe Qendrës për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura - DKAf, me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Maqedoni, më 25 dhe 26 qershor 2018, në Kuvend u mbajt Takimi vjetor i përfaqësuesve të komisioneve për Mbrojtje dhe Siguri të vendeve të Evropës Juglindore. Fjalim hyrës patën kryetari i Komisionit për Mbrojtje dhe Siguri, Hari Llokenec, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi, ambasadori i RAKVIAK-ut, Hajdar Berk dhe ministrja e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë, Radmilla Sheqerinska. Në Konferencën dyditore u debatua në tri panele të përkushtuara në këto tema: “Zgjerimi i misioneve jotradicionale të ushtrisë, roli i mbikëqyrjes parlamentare”; “Mbikëqyrja parlamentare mbi sektorin e mbrojtjes dhe sigurisë, praktikat e mira”; “Sfidat moderne të sigurisë në Evropën Juglindore”



Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në Asamblenë Parlamentare të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (AP e OSBE-së), në përbërje Jagoda Shahpaska, Vesna Damçevska - Ilievska dhe Rexhail Ismaili, më 4 qershor 2018 realizoi takim me SH.T. Robert Kirnag, ambasador i Republikës së Sllovakisë, përgjegjës për përgatitjet e Kryesimit të Sllovakisë me OSBE-në në vitin 2019. Në fjalimin hyrës, kryesuesja me takimin, Shahpaska, u shpreh e kënaqur nga vizita dhe mundësia për mbështetjen e një vendi mik. Ajo e potencoi kontributin e OSBE-së në demokratizimin e Republikës së Maqedonisë, në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike, decentralizimin, sundimin e së drejtës, të drejtat dhe liritë e njeriut, arsimin, mediet, si dhe rolin e OSBE/ODIHR-së në mbikëqyrjen e të gjitha proceseve zgjedhore.

Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë i përbërë prej deputeteve: Gjylmsere Kasapi, Irena Stefoska, Liljana Kuzmanovska dhe Mirsada Emini Asani më 8 qershor 2018 mori pjesë në Samitin e femrave lidere politike, që këtë vit u mbajt në Vilnius, Lituani. Delegacioni i Maqedonisë mori pjesë në mënyrë aktive në këtë Samit dhe në fjalimin e vet u përqendrua në temat rreth barazisë dhe përfaqësimit të femrave në politikën e Maqedonisë. Në mesin e shumë temave në të cilat u përqendrua Delegacioni i Maqedonisë veçanërisht u potencua rëndësia e Klubit Parlamentar të Deputeteve i cili këtë vit shënon 15 vjet nga ekzistimi dhe kontributi i vet. Në margjinat e Samitit, Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë realizoi takim të shkurtër bilateral me zëvendëskryeministrin e Rumanisë.



AKTIVITETET E KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE

Komisioni për Çështje Evropiane dha dritë të gjelbër për Maqedoni euroatlantike

Komisioni për Çështje Evropiane në mbledhjen e mbajtur më 20 qershor 2018 e shqyrtoi dhe me 10 vota "për", pa asnjë votë "kundër" dhe një "i përmbajtur", i propozoi Kuvendit të ta miratojë Propozim-ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes finale për zgjidhjen e dallimeve të përshkruara në rezolutat e Këshillit të Sigurisë të Kombeve të Bashkuara 817 (1993) dhe 845 (1993), për shfuqizimin e Marrëveshjes së përkohshme nga viti 1993 dhe për vendosjen e partneritetit strategjik ndërmjet palëve. Ministri i Punëve të Jashtme Nikolla Dimitrov Informoi hollësisht dhe saktësisht për të gjitha aspektet e Marrëveshjes, për procesin e negociatave me ç'rast theksoi se "i flijam mitet për fituar një realitet". I bëri thirrje edhe opozitës, duke cituar ekstrakte nga hyrja e raportit të Karnegies për Luftërat ballkanike dhe theksoi: "Në fakt nuk ka shpëtim, nuk ka dalje as për shtetet e vogla, as për shtetet e mëdha, përveç të bashkuar dhe të pajtuar". Artan Grubi, para anëtareve të Komisionit, theksoi se kjo Marrëveshje është një garant për të ardhmen e fëmijëve të tij, si dhe për të ardhmen e të gjithë fëmijëve në vendin tonë. Shprehu kënaqësi të madhe që i përket kësaj gjenerate politikanësh që kanë mundësi historike të japin ndihmesë për amanetin për gjeneratat e ardhshme. Mbledhje e Komisionit për Çështje Evropiane u ndoq edhe nga ana përfaqësuesve të shumtë të komunitetit ndërkombëtar në Republikën e Maqedonisë si mbështetje në përpjekjet të cilat vendi ynë i bën për proceset eurointegruese.




www.sobranie.mk

Në organizim të Parlamentit evropian në bashkëpunim me Dhomën e përfaqësuesve të Republikës së Çekisë, më 15 qershor 2018 në Pragë, u mbajt Konferenca Interparlamentare me temë: "Respektimi i lirisë së të shprehurit, duke e përfshirë edhe lirinë e mediave, në BE dhe më gjerë". Në Konferencën mori pjesë Delegacioni i Kuvendit në përbërje: Liljana Zaturaska, kryetare e Komisionit për Transport, Lidhje dhe Ekologji dhe anëtarët e Komisionit Bllagojçe Tërpevski, Rexhail Ismaili dhe Bllagoja Despotoski. Konferencën interparlamentare e hapi Radek Vondraček - kryetar i Parlamentit të Republikës së Çekisë dhe Barbara Spineli - anëtare e Parlamentit evropian (zëvendëskryetare e Komisionit për Çështje Kushtetuese, anëtare e Komisionit për Liri të Qytetarëve, Drejtësi dhe Punë të Brendshme). Temat e punës për të cilat u diskutua ishin: Roli i mediave në debatin politik; pronësia e mediave, transparenca dhe rregullimi; Ballafaqimi me lajme të rrejshme dhe dezinformime; Shoqëria civile si burim i informatave dhe mbështetjes për reforma politike; Liritë individuale, privatësia, enkriptimi, ndjekja e mediave sociale, ligji për shpifje dhe Sigurimi i mbrojtjes së gazetarëve dhe denoncuesve.



Instituti parlamentar i Kuvendit më 8 qershor 2018, ishte nikoqir në konferencën e katërt rajonale të qendrave hulumtuese në parlamentet me titull pune "Roli i parlamentit në nxitjen e pjesëmarrjes civile". Në konferencën marrin pjesë hulumtues nga gjashtë shërbime parlamentare nga rajoni të cilat morën pjesë edhe në përpunimin e studimit të përbashkët, si dhe përfaqësues të shërbimit parlamentar të Konfederatës zvicerane. Konferenca ishte vazhdimësi e përpjekjeve për këmbim më të mirë të informatave ndërmjet shërbimeve, në mbështetje të deputetëve.

KONTRIBUTI I BE-SË NË DIALOGUN TALAONA PËR AMBICJET KLIMATIKE



Komuniteti i biznesit dhe investitorët kanë bashkuar forcat e përbashkëta me autoritetet lokale dhe shoqërinë civile në një koalicion të vetëm, me qëllim t'i bëjnë thirrje liderëve të BE për të përshpejtuar tranzicionin drejt zero ekonomi karboni, me qëllim të mbahet ngrohja globale nën 2°C . Evropa duhet të rrisë nivelin e ambicies për të ruajtur ngrohjen globale "shumë nën 2°C ", e cila është gjithashtu qëllimi kryesor i Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike.

Pushtetet lokale dhe rajonale paraqiten përmes të ashtuquajturës Aleanca klimaterike e cila bashkon rreth 1.700 komunitat dhe kryetarët e komunave nga tërë bota. Kjo Aleanca obligohet për uljen e emetimeve të gazrave të qelqit për 10% në çdo 5 vite.

Përpjekja e Aleancës klimaterike është implementimi i plotë i Marrëveshjes së Parisit që do të thotë uljen e emetimeve të karbonit deri 2030 dhe uljen e emisioneve deri zero, më së voni deri 2050.

Në nivel evropian, kreatorët e politikës në moment diskutojnë për një sërë pako ligjesh me të cilat do të definohen politikat klimaterike dhe energjetike të BE-së për vitin 2030, duke përfshirë objektivat për emetimet e gazrave të qelqit, efikasitetin energjetik dhe burime të energjisë së rinovueshme.

Debati për udhërrëfimin me gazra të ulët të karbonit prej vitit 2050, pritët të fillojnë në korrik, me qëllim të miratohet Strategji Evropiane për të ashtuquajturën "mesi i shekullit" para zgjedhjeve evropiane vitin e ardhshëm.

Koalicioni i komunitetit të biznesit dhe organizatat e shoqërisë civile u bënë thirrje udhëheqësve të BE:

Të finalizohet miratimi i pakos së ligjeve të BE-së për energji të pastër për vitin 2030, në pajtim me nivelet e ambicies që i miratoi Parlamenti Evropian;

Të miratohet strategji afatgjate klimaterike e BE-së që do ta vendosë Evropën në rrugën drejt arritjes së qëllimit të Marrëveshjes së Parisit (1.5°C), e cila duhet të përfshijë qëllim për neto zero emetime deri në vitin 2050,

Rishikimi i qëllimit për uljen e emisioneve të gazrave të qelqit të BE-së nga viti 2030, me qëllim që të mundësohet BE që sërish të parashtojë ambiciet e tyre deri te KB deri në vitin 2020, siç është rënë dakord në Paris.

Thirrja për Koalicionin e Vetëm iu drejtua para mbajtjes së *Dialogut Talanoa* për ambiciet klimatike në kuadër të programit për ndryshime klimaterike të KB dhe paraqet proces ndërkombëtar i cili i ndjek përpjekjet kolektive dhe individuale drejt qëllimeve të Marrëveshjes për ndryshimet klimaterike të Parisit.

Më 13 qershor 2018 Në Bruksel, Komisioni Evropian organizoi konferencë me temë "BE për Talanoa" si pjesë e kontributit të BE-së në Dialogun Talanoa. Në konferencë morën pjesë rreth 600 pjesëmarrës nga sektori i biznesit, sektori civil, përfaqësues nga shtetet anëtare të BE, rajonet dhe qytetet nga BE, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare si dhe nga vendet e treta.

BE e thekson evidencën e saj për të paraqitur politikë ambicioze klimaterike dhe përpjekje për udhëheqjen globale, siç theksohet në kontributin e saj në Dialogun Talanoa. BE ka drejtuar ftesë deri tek të gjitha qeveritë që të sigurojnë përgjigje të besueshme deri në Dialogun Talanoa përmes aksioneve konkrete dhe progresin në zbatimin e politikave dhe masave për një periudhë prej 3 vitesh pas Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimaterike

#EU4Talanoa

<https://www.euractiv.com/section/energy/>

https://ec.europa.eu/clima/events/eu-talanoa_en

DITËT EVROPIANE TË ZHVILLIMIT 2018

Më 5 qershor të këtij viti, për herë të dymbëdhjetë u mbajtën Ditët Evropiane të Zhvillimit, të cilat bashkuan komunitetet për zhvillimin e Evropës dhe botës. Tema në Ditët Evropiane të zhvillimit të këtij viti ishte "Gratë dhe vajzat në krye të zhvillimit të qëndrueshëm: mbrojtje, nxitje, investim".

Ditët Evropiane të Zhvillimit filluan në vitin 2006 si mënyrë për të bashkuar komunitetin ndërkombëtar të zhvillimit dhe për të diskutuar rrugën për çrrënjosjen e varfërisë.

Këto ngjarje të organizuara nga Komisioni Evropian paraqesin pikë referimi të fortë për komunitetin ndërkombëtar të zhvillimit për të ndarë idetë dhe përvojat në mënyrë që frymëzon zgjidhje inovative dhe partneritete të reja për t'u përballur me sfidat më urgjente në botë.

Në eveniment morën pjesë kryetari i Komisionit Evropian Zhan-Klod Junker së bashku me përfaqësuesen e lartë të Unionit Federika Mogerini, nënkryetari i parë i Komisionit Evropian, Frans Timmermans, kryetari i Parlamentit Evropian Antonio Tajani, si dhe komisionarë, krerët e shteteve dhe qeverive, përfaqësuesit e OKB-së dhe të tjerë.

Gjashtëmbëdhjetë lider të rinj nga e gjithë bota ju bashkuan panelit të nivelit të lartë për këmbimin e ideve dhe përvojave me kreatorët e politikës dhe liderët botërorë.

Çmimi i Mediave "Lorenzo Natali" 2018 iu nda gazetarëve për raportimin e tyre të jashtëzakonshëm për zhvillimin e qëndrueshëm, me fokus të veçantë në eliminimin e dhunës kundër grave dhe vajzave.

Evenimenti i bashkon palët ndërkombëtare të prekura, në 92 stenda me mundësi për ndarjen e projekteve ose raporteve që lidhen me temat kryesore dhe temat e Ditës Evropiane të Zhvillimit.

Ditëve Evropiane të Zhvillimit iu bashkuan edhe shumë folës dhe pjesëmarrës të nivelit të lartë: Madhëria e saj Matilde Mbretëresha e Belgjikës, Madhëria e saj Mbretëresha Leticia nga Spanja, Madhëria e saj Mbretërore Maria Princesha e Danimarkës, presidenti i Maltës Mari-Luis Koleiro Preka, kryeministria e Norvegjisë Erna Solberg; Presidenti i Parlamentit Evropian Antonio Tajani; presidenti i Ruandës Poll Kagame, presidenti i Burkiës Faso Roç Mark Kristijan Kabore, presidenti i Nigerisë Mahamadu Isufu, presidenti i Liberisë Xhorxh Bah, zëvendëssekretarja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Amina Xh. Mohamed dhe shumë tjerë.

Që nga viti 2006, 100 lider botërorë, 7 laureatë për çmimin Nobël, 4500 organizata dhe 42,000 pjesëmarrës nga 154 vende morën pjesë në Ditët Evropiane të Zhvillimit.

<https://eudevdays.eu/>



STUDIMI PËR SUBVENCIONIMIN E KARBURANTËVE FOSILE



Në studimin për subvencionimin e karburantëve fosile të publikuar më 4 korrik 2018, theksohet se në vit derdhen së paku 100 miliardë dollarë për mbështetje të prodhimit dhe konsumit të naftës, gazit dhe qymyrit.

Liderët e G7 më 8-9 qershor të këtij viti u takuan në Çarlevuk, Kanadë, për shkak të presionit të rritur që të përmbushin premtimin për menaxhim me ndryshimet klimatike dhe reduktimin gradual të subvencioneve për karburantët fosile deri në vitin 2025 - premtim që së pari e bënë në vitin 2009.

Në dhjetor të vitit 2017, Banka Botërore i dha fund financimit të nxjerrjes së naftës dhe gazit. Por pavarësisht përpjekjeve, liderët e G7 siguruan mbështetje fiskale në shumën prej 80.62 miliardë dollarë dhe 19.54 miliardë dollarë në financat publike për karburantët fosile në vitet 2015 dhe 2016, thuhet në raport. Nga mbështetja, 64% u shfrytëzuan në transport, industri, ekonomi familjare dhe sektorë të tjerë.

Sipas Shelah Vitll, shef i programit të klimës dhe energjisë në Institutin për zhvillim jashtë vendit (ODI), "Vendet nga G7 vazhdojnë të subvencionojnë naftën, gazin dhe qymyrit, duke shkaktuar ndryshime të rrezikshme klimatike me paratë e tatimpaguesve",

Fushata për tu dhënë fund subvencioneve për karburantët fosile mori vrull kur G-20 e formoi Grupin e punës për transparencë financiare lidhur me klimën (TCFD) në dhjetor të vitit 2015. nën kryesimin e Majkl Blomberg, ish kryetar komune i Nju Jorkut. Grupi i punës dha rekomandime përfundimtare në qershor vitin e kaluar, duke kërkuar nga investitorët që të kuptojnë më mirë ekspozimin financiar ndaj rrezikut klimatik dhe të ju ndihmojnë kompanive që të publikojnë informacionet në mënyrë të qartë dhe të qëndrueshme.

Nëse do të ndiqeshin rekomandimet e grupit të punës, miliarda dollarë do të drejtoheshin larg nga karburantët fosile, pasi që investitorët i tërheqin mjetet e tyre nga industritë ndotëse dhe do të përqëndrohen në sigurinë afatgjatë të mjeteve, drejt teknologjive të pastra siç janë energjitë rigjeneruese.

Lidhur me vendet Evropiane, në raport theksohet kjo:

- Franca është detyruar ta zvogëlojë tatimin mbi tatimin e dizelit dhe benzinës deri në vitin 2021. Dhe përveç asaj që i lëshojnë hulumtimet vendore, institucionet financiare për financa publike kohë më parë u zotuan të financojnë hulumtim të ri të karburantëve jashtë vendit (për shembull, në vitin 2017 në Mozambik);

- Gjermania vazhdon të sigurojë financime të rëndësishme publike në bazë të karburantëve fosile (brenda dhe jashtë vendit). Ofron mbështetje të vazhdueshme fiskale për përdorimin e dizelit në transport;

- Italia siguron nivele të konsiderueshme të mbështetjes fiskale për sektorin e transportit, nga të cilët pjesë e madhe shkon në përdorimin e karburantit dizel;

- Mbretëria e Bashkuar është vërejtur se ka "transparencë jashtëzakonisht të dobët": nuk publikon raporte konkrete mbi mbështetjen fiskale të karburantëve fosile dhe nuk ka marrë pjesë në procesin e recenzionit të G-20. Përveç kësaj, përkundër angazhimeve të forta të nivelit të lartë dhe thirrjeve për përfundim të subvencioneve, qeveria mohon se siguron subvencione për karburantë fosile (sipas përkufizimit të vet qeveritar).

Në Bruksel, një grup ekspertësh i financave i formuar nga Komisioni Evropian e fton BE-ë t'i japë fund të gjitha financave publike për industritë e karburantëve fosile, si qymyri, nafta dhe gazi. Paratë publike duhet të drejtohen "vetëm për të mbështetur burimet rigjeneruese të energjisë dhe efikasitetin e burimeve".

<https://www.euractiv.com>

AGJENDA DIGJITALE PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

Komisioni Evropian më 25 qershor 2018, në Sofje e filloi Agjendën digjitale për Ballkanin Perëndimor, me qëllim të mbështes tranzicionin e rajonit në ekonominë digjitale dhe ti mundësoj përfitimet e transformimit digjital, si rritja ekonomike, vendet e punës dhe shërbimet më të mira.

Komisioni dhe ministrat nga gjashtë partnerët të Ballkanit Perëndimor - Serbia, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia dhe Kosova - do të përqëndrohen në investimet e brezit të gjërë, përmirësimin e sigurisë kibernetike, përf forcimin e ekonomisë digjitale dhe shoqërisë, avancimin e hulumtimeve dhe inovacionet.

Komisionerja Europiane për shoqëri dhe ekonomi digjitale Maria Gabriell theksoi se ngritja e Agjendës Digjitale për Ballkanin Perëndimor duhet të sigurojë që qytetarët nga rajoni të shfrytëzojnë plotësisht transformimin digjital të shpejtë dhe të pashmangshëm.

"Angazhimi për Agjendën Digjitale do të sigurojë që qytetarët të fitojnë aftësitë që i kërkon ekonomia e re dhe të ndihmojnë modernizimin e administratës publike, përf forcimin e sigurisë kibernetike, dhe të përmirësoj klimën afariste", tha Gabriell.

Komisioni Evropian njoftoi se në Kornizën e Investimeve për rajonin e Ballkanit Perëndimor (WBIF) 30 milionë euro do të jenë në dispozicion në grantet e infrastrukturës me brez të gjërë me qëllim të mobilizimit të investimeve strategjike dhe për të përshpejtuar rritjen socio-ekonomike.

Shqipëria tashmë ka marrë pako të ndihmës teknike si pjesë e WBIF si një nga pakot e investimeve të para. Në sferën e sigurisë kibernetike, BE dhe Ballkani Perëndimor kanë qëllim të përbashkët që të përmirësojnë sigurinë dhe besimin në internet.

Agjenda digjitale do të ofrojë mbështetje për e-qeverinë, e-shëndetësinë dhe do të ndihmojë në sigurimin e aftësive digjitale për qytetarët. Kjo do të mundësoj përmes nxitjes së pjesëmarrjes të vendeve të Ballkanit Perëndimor në iniciativat e BE-së, duke përfshirë Samitin e "Startap Europë 2018" në Sofje, duke u mundësuar kompanive rajonale të lidhen me aftësitë e programimit evropian, nxitjen e programimit dhe shkrim-leximin digjital në rajon.

Agjenda digjitale do të ndihmojë në krijimin

e qendrave hulumtuese nacionale, të zhvillohet e-infrastruktura më e re në Ballkanin Perëndimor dhe të integrohet në sferën evropiane digjitale hulumtuese.

"Këto përpjekje do të sjellin trajnimin më të mirë për gjeneratën e re të hulumtuesve dhe inxhinierëve dhe do të kontribuojnë në përf forcimin e bashkëpunimit ndërdisiplinor në të gjithë Evropën", theksohet në njoftimin e Komisionit Evropian.

Komisioni është i përkushtuar fortë në bashkëpunimin e ngushtë me të gjithë partnerët dhe autoritetet në Ballkanin Perëndimor në hulumtimin si mundet agjenda digjitale të jetë plotësisht e zbatueshme.

Agjenda digjitale për Ballkanin Perëndimor është një përpjekje e përbashkët e gjashtë partnerëve të Ballkanit Perëndimor dhe Komisionit Evropian.

E njëjta u prezantua më 6 shkurt 2018 si një nga gjashtë iniciativat kryesore për qëllimet e angazhimit në Porosinë për perspektivë të besueshme për zgjerimin dhe forcimin e angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor.

Angazhimi për fillimin e Agjendës digjitale u shpall gjatë Samitit Digjital për Ballkanin Perëndimor në prill të këtij viti, në të cilin ishte përfshirë udhërrëfyesi për uljen e tarifave të roamingut ndërmjet partnerëve të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.

<http://europa.eu>



PROGRAM INVESTUES PËR PËRKRAHJE TË VENDEVE TË PUNËS, RITJE DHE INOVACIONE NË EVROPË



Komisioni Evropian në buxhetin e ardhshëm afatgjatë të UE-së (2021-2027) propozon të krijohet Program investues (InvestEU Programme) me të cilën do të mundësohet kapshmëri të shumë programeve financiare dhe do ta zgjerojë modelin e suksesshëm të Planit Investues për Evropën - plani i Junkerit. Me këtë program Komisioni Evropian plotësisht do të japë përkrahje për krijimin e vendeve të punës, investime dhe inovacione.

Kryetari i Komisionit Evropian Zhan-Klod Junker sugjeroi se Plani investues për Evropën u tregua si i suksesshëm në lidhje me mobilizimin e investimeve private të vendeve të punës në Evropë. Me planin qenkan të krijuara investime prej pothuajse 290 miliardë euro, të cilat nuk do të realizohen pa Planin Investues. Me të njëjtin janë siguruar financa për 635.000 biznese të vogla. InvestUE paraqet model i suksesshëm i cili zgjerohet në shumë programe për financim të UE-së. Me projektin thjeshtëzohen punët, qëllimet realizohen me më pak hapa, ndërsa më i fortë është edhe fokusi i investimeve sociale.

Programi do të ndihmojë të realizohen qëllimet të politikës, siç janë qëndrueshmëria, suksesi në shkencë, përfshirja sociale dhe zmadhimi i përkrahjes për bizneset e vogla, me qëllim të mobilizohen mbi 650 miliardë euro investime - kryesisht nga sektori privat.

Programi i ri do të përbëhet nga Fondi InvestUE, Qendra konsultative InvestUE dhe Portali InvestUE. Me Fondin InvestUE do të vazhdojë të mobilizohen investimet publike dhe private në UE që të ndihmohet me zgjedhjen në zgjedhjen e ende ndarjes së madhe investuese në Evropë.

Në bazë të modelit të Qendrës adekuate investuese të Evropës për investime, do të integrohen 13 shërbime të ndryshme këshillëdhënëse që momentalisht janë të kapshme në qendrën njësportelsh për ndihmë të projekteve. Ajo do të sigurojë përkrahje teknike dhe asistencë në përgatitjen, strukturimin dhe zbatimin e projekteve, zhvillimin, duke e përfshirë edhe ndërtimin e kapaciteteve.

Portali i projekteve investuese jep pasqyrë të pastër për projektet investuese në UE dhe do të jetë në korniza të Programit InvestUE. Portali i bashkon investitorët dhe promotorët të projekteve nëpërmjet sigurimit të bazë lehtë të kapshme dhe të përdorshme të të dhënave, duke u dhënë shikueshmëri më të madhe të projekteve dhe u mundëson investitorëve të gjejnë mundësi për investim në sektorin ose lokacionin i cili u është lëndë e interesi.

Marrëveshja për përcjellje të buxhetit afatgjatë në vitin 2019 do të sigurojë tranzitim të papenguar ndërmjet buxhetit rrjedhës afatgjatë (2014-2020) dhe buxheti i ri, ndërsa do të

sigurojë parashikim dhe vazhdimësi të financimit në dobi të të gjithëve.

Plani investues për Evropën, plani i Junkerit, filloj në nëntor 2014 që të ndryshohet trendi i zvogëlimit të nivelit të ulët të investimeve dhe të vihet Evropa në rrugën e shërimit ekonomik. Operacionet të lejuara sipas Fondit evropian për investime strategjike për Planin e Junkerit pritet të mundësojë investime prej 287 miliardë euro nga maji i viti 2018. Rreth 635.000 ndërmarrje të vogla dhe të mesme pritet të kenë dobi nga qasja e përmirësuar të mjetet financiare.

Parlamenti evropian dhe vendet-anëtare më 12 dhjetor 2017, u morën vesh për Rregullativën për përmirësim të EFSI dhe zgjerimin e qëllimit investues të 500 miliardë euro deri në fund të viti 2020. Rregullativa e EFSI 2.0 shkallë në fuqi më 30 dhjetor 2017.

<https://ec.europa.eu>

PRODHIIMTARI E ZVOGËLUAR E CIGAREVE NË UNIONIN EVROPIAN

Në Unionin Evropian në vitin 2016 ishin prodhuar më shumë se 527 miliardë cigare, që është 36 miliardë më pak sesa në vitin 2015 dhe rreth 1/3 para më pak se 10 vjet. Prodhuesi më i madh është Gjermania, ndërsa Serbia, sipas Eurostat (Agjencia evropiane për statistikë) ka prodhuar pothuajse 35 miliardë cigare. Eurostat i shpalli këto informata me rastin e Ditës botërore pa tym nga cigaret, e cila shënohet më 31 maj.


Në vendet të UE-së qenkan të prodhuara më shumë se 1.000 cigare për kokë banori, ose rreth 50 paketime nga 20 cigare. Vlera e përgjithshme e cigareve është rreth 6,2 miliardë euro.

Më së shumti cigare qenkan të prodhuara në Gjermani, pothuajse 168 miliardë, përkatësisht 32% nga gjithsej të prodhuarat në UE. Kjo do të thotë çdo cigare e tretë e bërë në UE vjen nga Gjermania.

Në vend të dytë është Polonia, me 96 miliardë cigare të prodhuara në vitin 2016, përkatësisht 19% nga prodhimtaria në UE, ndërsa prapa asaj është Rumania, e cila ka prodhuar 77 miliardë cigare, përkatësisht 15% nga prodhimtaria e përgjithshme në UE.

Ndër të parët pesë prodhues të cigareve në UE janë Greqia (31 miliardë), Portugalia (27 miliardë) dhe Bullgaria (21 miliardë).

<http://ec.europa.eu>



(2016 data)

ec.europa.eu/eurostat



KALENDARI I BE-SË / korrik 2018

1. Kryesimi austriak me Këshillin e UE-së -01/07/2018 - 31/12/2018;
2. sesioni i planifikuar i Parlamentit Evropian - 02-05/07/2018, Strasburg;
3. Sesion plenar i Komitetit Evropian i regjioneve, 04/07-05/07/2018, Bruksel;
4. Debat publik për ardhmërinë e UE strategjisë për të rinj, 09/07/2018, Bruksel.
5. Konferenca për "Vizionin e UE-së për ekonomi moderne dhe të pastër, 10/07-11/07/2018, Bruksel"

European Union
 Newsroom

[EUROPA](#) > [Newsroom](#) > [Calendar](#)

[Home](#)
[Highlights](#)
[Press releases](#)
[Calendar](#)
[Audiovisual](#)
[Press contacts](#)
[Press facilities](#)
[Subscription services](#)
[About the EU](#)

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic

By organiser

By type

BY MONTH

July

Sun	Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 tetori nr. 10, Shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 55 lokali 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në periudhën janar 2011-qershor 2012 ishte zbatuar IPA Projekti për "Ndihmë teknike për Parlamentin", qëllimi i përgjithshëm i të cilës ishte përforcimi i kapacitetit institucional të Kuvendit dhe me atë përmirësim të transparencës dhe përgjegjësisë të saj para qytetarëve.

Në korniza të IPA projektit, ishte siguruar ndihmë financiare dhe profesionale për vendosje të UE qendre në Kuvend.

Qëllimi i formimit të UE qendrës është deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe Shërbimit të Kuvendit t'u sigurohet qasje më e mirë në informata të lidhura me UE çështjet.

UE qendra me organizim është në korniza të Sektorit për përkrahje të Këshillit kombëtar për eurointegritime.

UE qendra disponon me bibliotekë të librave dhe publikimeve nga sfera të ndryshme të politikave evropiane.

